

Departamenti i Prokurimit

Prishtine datë, 25.05.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 21.05.2021 të parashtruar nga Grupi i Operatori Ekonomik “Grami SHPK”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me makina pastrimi”, me Nr. të Prok: 616 21 037 121 nxjerr:

VENDIM

1. **Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e Grupi i Operatori Ekonomik “Grami SHPK”, të dt. 20.05.2021 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me makina pastrimi”, me Nr. 616 21 037 121 Nr. Brendshëm **616-21-1071-1-2-1**, kundër Njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, të datës 17.05.2021 .
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që *te vazhdoj me aktivitetin e prokurimit*;
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Grupi i Operatori Ekonomik “GRAMI shpk” me datë 21.05.2021, ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me makina pastrimi”, me Nr. 616 21 037 121 Nr. Brendshëm **616-21-1071-1-2-1**,


Autoriteti Kontraktues, me datë 25.05.2021, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë dhe ka konstatuar si vijon :

-Pretendimet tuaja janë të pa bazuara, pasi që të gjithë tenderuesit që ju i keni konsideruar si të pa përgjegjshëm lidhur me specifikimet teknike të produktit nuk qëndrojnë. Në ofertat e dorëzuara nga ata tenderues janë dorëzuar edhe pjesë të katalogjeve të cilat janë në harmoni të plote me kërkesat e FDT-së respektivisht me Aneksin 1 të Dosjes së tenderit. Pothajse të 3 të gjithë tenderuesit kanë ofruar tipin B 7501 të Cleanvac dhe një tjetër tipin Star SC 50 B dhe deshmite e dorëzuara janë në harmoni me kërkesat tona.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.



Zyrtari përgjegjës i Prokurimit